



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit -III-
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Nr. I prot. 3967
Br. prot. Dt. 04.12.2025
RAHOVEC - ORAHOVAC

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Datë/e	04.12.2025
Referencë/e	
Për/To:	Kryetarin e Komunës- Z.Smajl Latifi
CC:	Kuvendit të Komunës së Rahovecit
Përmes/Through:	Drejtëpërdrejt
Nga/From :	Z. Afrim Oruqi Drejtëtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Subjekt/Subject:	Plani i punës për vitin 2026

Plani i punës për vitin 2026

Nga: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Fillimi i vitit të ri, do të filloj me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak.

Qysh në fillim të vitit 2026 do t'i qasem punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësisë të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës së Rahovecit.

PRIORITETET e vitit 2026

Përfundimi i ri rregullimit të vektorit në të gjitha Zona Kadastrale në nivel Komune.

Digjitalizimi kadastral.

Prioritet kryesor gjatë vitit 2026 do të fokusohet në shërbime cilësore në përputhje me afatet kohore dhe të unifikuara ligjërisht.

Qëllimi kryesor i drejtorisë do të jetë i fokusuar në shërbime komfor akteve juridike.

Vazhdimi i evidentimit dhe lirimit të pronave të uzurpuara në nivel të komunës.

Vazhdimi i inventarizimit të dokumentacionit dhe skenimi masiv i dokumentacionit të pa skanuar.

Shpronësimi i pronave private dhe të institucione të ndryshme shoqërore për interes të përgjithshëm publik në nivel të Komunës.

SFIDAT e vitit 2026

Përfundimi i ri rregullimit të vektorit në të gjitha Zona Kadastrale në nivel Komune.

Themelimi i komisionit për komosacion me institucione të tjera qendrore sipas ligjeve në fuqi.

Dua të theksoj se në kuadër të Drejtorisë ekzistojnë dy sektorë:

Spektori për Kadastër dhe Pronë dhe

Spektori për Gjeodezi

Numri i punëtorëve në këtë drejtori është me sa vijon;

Gjithsej 11-të punëtorë, ku prej tyre, gjasht janë me përgatitje të lartë shkollore (jurist-gjeodete, gjeograf, IT), tre janë gjeodetë/e ku të tret janë me përgatitje të lartë gjeodezike, një konsulente dhe një vozitës.

Spektori për Kadastër dhe Pronë, gjate periudhës një vjeqare parashihet që të pranoj dhe kryej me shumë se 1700 lëndë.

Spektori për Gjeodezi parashihet që të pranojë dhe zgjidhë mbi 760 lëndë.

Vlen të përmendet sektori i gjeodezisë për punën e tyre që do ta ken në terren, si dhe shërbimi pronësoro juridik për angazhimin e dhënë në përgatitjen e akteve si për nevoja të Kuvendit të Komunës ashtu edhe përgatitjen e akteve për persona fizik dhe juridik.

Do të vazhdojm me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me evidentimin e pronave si ato komunale dhe ato private që janë në interes të përgjithshëm publik.

Gjatë vitit 2026 nuk do të mungojë edhe qasja ndaj detyrave të tjera, si në sektorin e gjeodezisë ashtu edhe në atë të kadastrës dhe pronës, ku vlen të cekën:

- Propozim vendimet për seancat e Kuvendit Komunal.
- Përgatitja e lëndëve për gjykatë dhe subjekteve të tjera të përfshira në zbatimin e ligjit.
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe personave juridik.
- Punët e gjeodezisë inxhinierisë për nevojat e Kuvendit Komunal dhe palëve të tjera.
- Matjet kadastrale për vërtetimin e uzurpimeve arbitrare.
- Përgatitja e Aktvendimeve për uzurpimet arbitrare,
- Punë të tjera sipas planit.

❖ **Me propozim të Kryetarit të Komunës, drejtuar Kuvendit të Komunës, do të bëhet shpallja e interesit të përgjithshëm të pronave publike, private dhe të institucioneve të ndryshme shoqërore për zhvillim ekonomik të Komunës.**

❖ **Detyrat tjera të Drejtorisë**

- Përgatitja e akt dokumentit për angazhimin e gjeodeteve Komunal jashtë drejtorisë.
- Përgatitja e akteve ndaj uzurpatoreve në nivel të Komunës
- Dalja në terren e Shërbimit pronëso-ro-juridik, me kërkesë të Drejtorisë për Inspeksion.
- Dalja e gjeodetëve në terren në nivel Komune sipas kërkesave të drejtorive.

Me respekt!